



OJQ “Kasneçet e Ardhmërisë” – KeA, është organizatë joqeveritare e cila zbaton projektin “Fuqizimi i Kontrollit të Tuberkulozit në Kosovë”, projekte janë financuar nga ana e GFATM nëpërmjet të CDF. Në lidhje me këtë projekt OJQ KeA shpall konkurs për këtë pozitë:

Trajner IT për trajnimin njëditor të futësve të të dhënave në sistemin elektronik të menaxhimit të sëmundjeve ngjitëse (me fokus në Tuberkuloz - TB)

Detyrat dhe përgjegjësitë e trajnerit

- Përgatitja e agjendës dhe materialeve për trajnimin njëditor
- Zhvillimi i sesioneve teorike dhe praktike me pjesëmarrësit.
- Demonstrimi i përdorimit të modulit TB në bazën e të dhënave.
- Mbështetja e pjesëmarrësve gjatë ushtrimeve praktike.
- Përgatitja e raportit përmbledhës mbi ecurinë e trajnimit dhe rezultatet e pjesëmarrësve.

Kualifikimet e kërkuara

- Diplomë universitare në IT, Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri, Shkenca Shëndetësore ose fusha të ngjashme.
- Përvojë të mëparshme në trajnime të sistemeve elektronike shëndetësore (p.sh. DHIS2, eTB Manager, Epi Info, REDCap etj.).
- Aftësi për komunikim të qartë dhe prezantim profesional.
- Përvoja në trajnime të ngjashme me institucionet shëndetësore përbën avantazh.

Kohëzgjatja dhe vendi i angazhimit

Kohëzgjatja: 1 ditë pune (trajnim njëditor + përgatitje paraprake), që mund të përsëritet në vitet e ardhshme. Vendi: Sipas planifikimit të projektit. Angazhimi bëhet me kontratë shërbimi.

Dokumentet për aplikim

- CV e përditësuar;
- Kopje e diplomës dhe certifikatave relevante;
- Referenca nga angazhime të ngjashme.

Mënyra e aplikimit: Aplikimet duhet të dërgohen me email në adresën: rinarexha28@gmail.com; me subjektin: “Aplikim për pozitën Trajner IT – Trajnim njëditor për sistemin e sëmundjeve ngjitëse (TB)”. Afati i fundit për aplikim: 17 tetor 2025